

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në shërbim të:

- Sigurimit të gatishmërisë operationale dhe vigjilencës ndaj çdo situatë që mund të ketë ndikim në stabilitetin financiar në vend;
- Ruajtjes së stabilitetit financiar dhe shmangies së krizave të mundshme financiare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit përfundimtar të shërbimeve bankare, nëpërmjet ndërtimit të urave të komunikimit ndërmjet autoriteteve rregullatorë dhe mbikëqyrëse të sistemit bankar shqiptar;
- Rolit të ri që iu caktua me ligjin nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” si administratore e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

Konstaton se gjatë vitit 2018 Agjencia:

- Ka vijuar të mbetet e angazhuar në drejtim të përmbushjes me eficiencë të mandatit të saj ligjor, e udhëhequr edhe nga rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për këtë vit.
- Ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional, si anëtar i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, dhe ka qenë në kontakt dhe konsultim të vazhdueshëm me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, si partnerët strategjikë parësorë të Agjencisë në drejtim të objektivit të përbashkët të stabilitetit financiar.
- Ka konsideruar dhe ka marrë masa për respektimin dhe vënien në zbatim për vitin 2018 edhe të rekomandimeve të Kuvendit.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që gjatë vitit 2019:

- Në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë, si dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, të shqyrtojë dhe të vlerësojë përshtatshmërinë e treguesve të skemës së sigurimit të depozitave, duke përfshirë, ndër të tjera, normën e primit të sigurimit, nivelin e mbulimit për depozitat e siguruara, kategoritë e depozitave të sigurueshme dhe atyre të përjashtuara nga sigurimi, si dhe raportin e synuar të mjaftueshmërisë së fondeve që Agjencia administron.
- Të vijojë testimin e sistemit, për sa i takon gatishmërisë në rast ngjarjeje sigurimi, infrastrukturën IT, komunikimin me depozituesit, ashtu si dhe bankën në likuidim dhe bankën agjente të përzgjedhur nga Agjencia për kryerjen e një procesi kompensimi, duke kryer simulime teknike dhe tematike, si dhe duke u angazhuar në simulimet ndërinstitucionale apo simulime për raste të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim testimin e procedurave operationale të hartuara në letër.
- Të thellojë më tej bashkëpunimin me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rolin kyç të këtij institucioni, si autoriteti përgjegjës rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar dhe financiar, si dhe misionin e përbashkët të dy institucioneve në drejtim të zhvillimit të një sistemi financiar të shëndetshëm në shërbim të publikut dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë.

Miraturar në datën 8.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi